

UDHËZIM
Nr. 31, datë 29.12.2017

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, DOKUMENTACIONIT DHE PROCEDURAVE
PËR HAPJEN, RIORGANIZIMIN DHE MBYLLJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT
NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË**

Në mbështetje, të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 6, të nenit 35 të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Institucioni i Arsimit të Lartë (IAL) depoziton në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë (MASR) dokumentacionin dhe formularin sipas shtojcës 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, për hapjen dhe/ose riorganizimin e një ose disa programeve studimi. Afati i fundit i depozitimit është data 30 nëntor, për vitin akademik pasardhës.

2. Hapja dhe/ose riorganizimi i një ose disa programeve studimi bëhet duke u mbështetur në vlerësimin e nevojave për njohuri, aftësi dhe kompetenca në tregun e punës, si edhe duke u provuar nga ana e subjektit se është në gjendje të ofrojë garancitë e nevojshme akademike e infrastrukturore dhe mbështetjen e nevojshme financiare për veprimtarinë e kërkuar.

3. Miratimi i hapjes së programeve të studimit bëhet kur plotësohen kriteret infrastrukturore, organizative dhe ato të lidhura me personelin akademik që do të përfshihet në realizimin e disiplinave apo veprimtarive të tjera formuese. Hapja e programeve të studimit bëhet me urdhër të ministrit të MASR-së, pas plotësimit të kriterëve dhe kërkesave ligjore në fuqi.

KREU II
**DOKUMENTACIONI PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT PËR TË
GJITHA CIKLET**

1. Dokumentacioni që IAL depoziton për hapjen e programeve të reja të studimit për të gjitha ciklet përbëhet nga:

a) Kërkesa e hapjes së programit/eve të reja të studimeve, në të cilën specifikohen njësia bazë që do ta ofrojë atë, emërtimi, cikli, lloji dhe kodi i programit të studimit, kreditet që fitohen, kohëzgjatja normale, forma dhe gjuha e studimit, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

b) Të dhënat për aktin e hapjes dhe të lejes për fillimin e veprimtarisë akademike të institucionit dhe aktin e hapjes/riorganizimit të njësisë kryesore që e ofron, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

c) Propozimi i njësisë bazë, shoqëruar me argumentet përkatëse që mbështesin nevojën për hapjen e programit/programeve të ri/reja.

d) Vendimi i Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit, që miraton hapjen e programit/eve të studimit. Në rast se propozimi vjen nga një institucion publik i arsimit të lartë dhe kërkon financim nga buxheti i shtetit depozitohet miratimi paraprak i Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL).

e) Mandatpagesën për vlerësimin nga ekspertit të programit sipas përcaktimeve në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 418, datë 10.5.2017, “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre” dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 109, datë 15.2.2017, “Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë së sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë e të bordit të akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, të Këshillit të Ministrave.

f) Lista e plotë emërore e personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, për të gjitha programet e studimit, së bashku me ngarkesat dhe formën e punësimit, si dhe titullin dhe gradën përkatëse. Dosja e

personelit përmban:

- i) jetëshkrimin;
- ii) kontratën e punës për personelin efektiv ose një aktmarrëveshje dypalëshe për personelin e planifikuar për t'u angazhuar me kohë të plotë në rast të hapjes së programit;
- iii) dokumente që vërtetojnë shkollimin e kualifikimet, titujt dhe gradat (fotokopje);
- iv) letrën e angazhimit të çdo anëtarit të personelit akademik të planifikuar për t'u angazhuar me kohë të pjesshme dhe lejen e punëdhënësit kryesor (sipas nenit 64, pika 2 e ligjit nr. 80/2015).
- v) Në rastin e hapjes së një programi studimi në gjuhë të huaj, personeli akademik i rekrutuar duhet të plotësojë së paku një nga kriteret e mëposhtme:
 - Të ketë fituar së paku një diplomë të një programi studimi në një nga ciklet e studimeve universitare të kryer në gjuhën në të cilën do të zhvillohet programi i studimit.
 - Të zotërojë nivelin C1 të njohjes së gjuhës respektive, në të cilën do të ofrohet programi, e vërtetuar përmes testeve ndërkombëtare, të cilat ndodhen në listën e miratuar nga MASR-ja për pranimet në ciklin e dytë dhe të tretë.
- vi) Deklaratë mbi numrin e përgjithshëm të studentëve ekzistues dhe të kuotave të studentëve të parashikuara për programin/et të reja që kërkohen të hapen. Kjo deklaratë të shoqërohet me deklaratën nga subjekti (*të nënshkruar nga titullari dhe me vulën e institucionit*) mbi përmbushjen e standardeve akademike dhe të infrastrukturës dhe mbi sigurimin e mjeteve të nevojshme financiare për përfundimin e studimeve nga secili student i regjistruar, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.
- g) Modeli i kontratës së shërbimit (regjistrimit) që studenti lidh me IAL-në, si dhe tarifa e shkollimit për studentët, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- h) Në rast se IAL-ja parashikon zgjerim të infrastrukturës ekzistuese në dispozicion të programeve, të depozitohet:
 - i) relacioni i verifikimit të godinës së re, i përpiluar nga një person juridik apo fizik i licencuar nga organi kompetent shtetëror, sipas kuadrit ligjor në fuqi (*shoqëruar me kopjen e njëzuar me origjinalin të licencës së këtij të fundit*).
 - ii) Planimetria dhe planvendosja e godinës/pjesës së re të institucionit, leja e shfrytëzimit të godinës, së bashku me bazën materiale dhe didaktike. Aktin e posedimit të godinës apo kontratën e qirasë me afat së paku 3-vjeçar, të shoqëruar me vërtetimin e pronësisë të qiradhënësit.
- i) Dokumentacion mbi programet e studimit, të plotësuar në të gjitha elementet e tij, në zbatim të VKM-së për elementet e programeve të studimit:
 - i) Rregullorja e IAL-së;
 - ii) Rregullore mësimore e programit të studimit;
 - iii) Plan mësimor për çdo program studimi;
 - iv) Programet e lëndëve (syllabuset) të nënshkruara nga hartuesit/titullarët e tyre. Në rastin kur IAL-ja aplikon për hapjen e më shumë se një programi studimi në të njëjtën kohë, syllabuset e lëndëve që mund të shfaqen në më shumë se një program studimi depozitohen në një kopje të vetme.
- j) Gjithë dokumentacioni i përcaktuar në pikën 1 të këtij kreu duhet të depozitohet edhe i skanuar në format elektronik (PDF) në një CD/*flash drive*, të cilat paraqiten së bashku me dokumentacionin për aplikim.
- k) Në rast bashkëpunimi me një institucion tjetër vendës ose të huaj të arsimit të lartë për hapjen e programeve të përbashkëta të studimit, së bashku me dokumentacionin e mësipërm, kërkohet depozitimi edhe i:
 - i) Aktit të themelimit/licencimit të institucionit në vendin e origjinës.
 - ii) Aktit të akreditimit të institucionit partner ose të programit të studimit.
 - iii) Dokumentit zyrtar bashkëpunimi (*marrëveshje kuadër*), ku parashikohet ofrimi i programeve të përbashkëta të studimit.
 - iv) Marrëveshjes specifike për programin konkret të studimit, ku të parashikohen modalitetet e ofrimit të tij, si autorësia dhe pronësia e syllabuseve të depozituara, gjuha dhe metoda e mësimimit dhe provimeve, shkëmbimi i stafit pedagogjik etj. Kjo marrëveshje mund të jetë dhe në formën e rregulloreve të përbashkët mësimore.
 - v) Llojit të diplomës (*e dyfishhtë, e shumëfishhtë, e përbashkët*) dhe modelin e diplomës të miratuar nga të dyja palët.
 - vi) Deklaratë për plotësimin e standardeve akademike edhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi (deklarata e nënshkruar nga titullari dhe me vulë të institucionit), sipas shtojcës 1, bashkëlidhur dhe pjesë

përbërëse e këtij udhëzimi.

l) Në rast deklarimi të rremë, subjekti juridik i nënshtrohet përgjegjësisë penale të parashikuar në Kodin Penal. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, MASR-ja nis procedurën e kontrollit dhe më pas, në rast të vërtetimit të dyshimeve, ia përcjell të dhënat organit kompetent.

2. Procedura për shqyrtimin e aplikimeve për hapjen e programeve të reja të studimit të të gjitha cikleve.

a) Kërkesa dhe dokumentacioni, i përcaktuar në pikën 1 të këtij kreu, depozitohen në MASR. Struktura e ngarkuar së bashku me strukturat juridike, brenda tri javëve, bën shqyrtimin paraprak të dokumentacionit. Në rastet kur dokumentacioni është i paplotë apo konstatohen mangësi/pasaktësi, MASR-ja i kërkon IAL-së që të bëjë plotësimin /saktësimin e dokumentacionit, brenda katër javëve nga data e kthimit për plotësim /saktësim. Në mungesë të plotësimit/saktësimit të dokumentacionit të kërkuar, praktika përkatëse refuzohet dhe arkivohet, duke konsideruar që subjekti ka hequr dorë në heshtje nga kërkesa e bërë.

b) Dokumentacioni i përcaktuar në pikën 1 të këtij kreu i kalon për vlerësim ekspertit, të caktuar nga MASR-ja, i zgjedhur nga lista e ekspertëve të miratuar.

Eksperti brenda tre javësh dorëzon raportin e vlerësimit në MASR. Në rastet kur dokumentacioni është i paplotë apo konstatohen mangësi/pasaktësi nga eksperti, subjektit i kërkohet plotësimi i tij, brenda tri javësh nga marrja e njoftimit nëpërmjet ministrisë.

c) Dokumentacioni i plotësuar i kalon për rivlerësim ekspertit, i cili, brenda tri javësh, dorëzon raportin e rivlerësimit në MASR. Praktika nuk mund të shqyrtohet më shumë se dy herë. Në rastet kur dokumentacioni është përsëri i paplotë, praktika përkatëse refuzohet dhe arkivohet.

d) Në rast kur vlerësimi përfundimtar i MASR-së është pozitiv, ministri miraton hapjen e programit të ri të studimit.

e) Në rast ankese nga ana e subjektit, ministri i MASR-së i kërkon mendim të argumentuar me shkrim Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator. Në përfundim është ministri i MASR, që vendos mbi refuzimin apo vijimësinë e praktikës së depozituar. Në rast refuzimi, praktika arkivohet në MASR.

KREU III

DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURAT PËR RIORGANIZIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË TË GJITHA CIKLEVE

1. Dokumentacioni që IAL-ja depoziton për riorganizim të programeve të studimit përbëhet nga:

a) Kërkesa e institucionit për riorganizim programesh studimi, lloji, forma dhe gjuha e studimit, shoqëruar me të dhënat për aktin e hapjes/riorganizimit të programeve të studimit ekzistuese që kërkohen të riorganizohen. Në kërkesë argumentohen arsyet që mbështesin kërkesën për riorganizimin e programit.

b) Vendimi i Senatit dhe i Bordit të Administrimit të IAL-së.

c) Planet mësimore të programeve të propozuara.

d) Rregulloren e ciklit të studimeve të programeve që riorganizohen.

e) Programet e lëndëve (syllabuset) të nënshkruara nga titullari i lëndës.

f) Lista e stafit akademik në funksion të programeve të studimit dhe forma e angazhimit (me kohë të plotë, me kohë të pjesshme).

2. Procedura e shqyrtimit të riorganizimit të programeve të studimit.

a) Kërkesa dhe dokumentacioni depozitohen në MASR. Shqyrtimi mbi plotësimin dhe rregullsinë e praktikës së depozituar me dokumentet e kërkuara sipas këtij udhëzimi bëhet nga njësia përgjegjëse dhe struktura juridike në MASR, brenda tri javëve nga depozitimi i kërkesës. Në rastet kur dokumentacioni është i paplotë apo konstatohen mangësi/pasaktësi, MASR-ja i kërkon IAL-së të bëjë plotësimin/saktësimin e dokumentacionit brenda katër javëve nga data e kthimit për plotësim/saktësim. Në mungesë të plotësimit/saktësimit të dokumentacionit të kërkuar, praktika përkatëse refuzohet dhe arkivohet.

b) Dokumentacioni i kalon për vlerësim ekspertit. Eksperti brenda tri javësh dorëzon raportin e vlerësimit në MASR. Në rastet kur dokumentacioni është i paplotë apo konstatohen mangësi/pasaktësi nga eksperti, subjektit i kërkohet plotësimi i tij, brenda tri javësh nga marrja e njoftimit.

c) Dokumentacioni i plotësuar nga subjekti i kalon për rivlerësim ekspertit. Eksperti brenda tri javësh dorëzon raportin e rivlerësimit në MASR. Praktika nuk mund të shqyrtohet më shumë se dy herë. Në rastet kur dokumentacioni është përsëri i paplotë, praktika përkatëse refuzohet dhe arkivohet.

d) Në rast kur vlerësimi përfundimtar i MASR-së është pozitiv, ministri miraton programin e

riorganizuar të studimit.

e) Në rast ankese nga ana e subjektit, ministri i kërkon mendim të argumentuar me shkrim Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator. Në përfundim është ministri i MASR-së, që vendos mbi refuzimin apo vijimësinë e praktikës së depozituar. Në rast refuzimi, praktika arkivohet në MASR.

f) Në rastin kur riorganizimi i programit bëhet për shkak të ndryshimeve në legjislacionin për arsimin e lartë, përshtatja e programeve të studimit me ndryshimet ligjore bëhet me vendim të Senatit Akademik të institucionit. MASR-ja, pasi njoftohet me shkrim nga institucioni i arsimit të lartë për ndryshimet e bëra në programet e studimit, në përputhje me kërkesat e reja të legjislacionit, merr masat për reregjistrimin e formave të reja të diplomave (nëse është e nevojshme).

KREU IV

PROCEDURAT PËR MBYLLJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË TË GJITHA CIKLEVE

1. Akti për hapjen e një programi studimi anulohet në rastet si më poshtë:

a) Institucioni i arsimit të lartë për arsye të ndryshme i drejtohet ministrit të MASR-së me kërkesën për mbylljen e një ose disa programeve të studimit të ofruar nga ky institucion. Kërkesa duhet të shoqërohet me vendimet përkatëse të Senatit Akademik dhe të Bordit të Administrimit. Institucioni është përgjegjës për pasojat juridike të ardhura nga mbyllja e programit për studentët që kanë përfunduar programin apo janë në proces ndjekje të programit.

b) Në rast se institucioni i arsimit të lartë nuk e aktivizon programin brenda dy viteve akademike të njëpasnjëshme nga dalja e urdhrit të hapjes, leja e dhënë për hapjen e këtij programi studimi bëhet e pavlefshme.

c) Në rastin kur programi i aktivizuar i studimit bëhet joaktiv për dy vite akademike të njëpasnjëshme, leja e dhënë për hapjen e këtij programi studimi bëhet e pavlefshme.

d) Programi i studimit i bërë i pavlefshëm, mund të rihapet pasi IAL-ja depoziton në MASR projektin për rihapjen e tij, si kërkesë për program të ri.

e) Bazuar në konstatime të vërtetuara mbi mosrespektimin, nga ana e një institucioni të arsimit të lartë, të kriterëve të ligjshmërisë dhe/ose të akreditimit të një programi studimi.

2. Bazuar në rastet e përcaktuara në germen “a” të pikës 3 të këtij kreu, ministri i MASR-së urdhëron mbylljen e programit përkatës, në fund të vitit akademik.

3. Studentët që nuk kanë përfunduar ende studimet në programin që mbyllet, kanë të drejtë të transferojnë studimet brenda të njëjtë institucion ose në një institucion tjetër të arsimit të lartë.

KREU V

KRITERET E POSAÇME PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË CIKLIT TË TRETË TË STUDIMIT, “SPECIALIZIME AFATGJATA NË FUSHËN E MJEKËSISË”

1. Kriteria të përgjithshme për hapjen e programeve të reja të ciklit të tretë të studimit, “Specializime afatgjata në fushën e mjekësisë”

a) Këto programe organizohen dhe realizohen nga IAL-të të cilat janë të integruara me strukturat shëndetësore universitare ose nga IAL-të që kanë marrëveshje bashkëpunimi me strukturat shëndetësore universitare.

b) Strukturat shëndetësore universitare dhe të rrjetit formues duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për strukturat shëndetësore, si dhe standardet specifike të programeve të studimit, në të dyja rastet e përcaktuara në shkronjën “a” të kësaj pike.

c) IAL-të, publike dhe jopublike, vendëse ose të huaja, që paraqesin kërkesën për hapjen e programeve të studimit pranë ministrit, duhet të kenë zhvilluar dhe akredituar /riakredituar programe të studimit të integruara të ciklit të dytë në fushën e mjekësisë, të paktën me kohëzgjatje 5-vjeçare (300 ECTS) në programet Stomatologji dhe Farmaci, dhe të paktën 6-vjeçare (360 ECTS), në programin Mjekësi e Përgjithshme.

d) Hapja e programeve të studimit bëhet kur plotësohen kriteret infrastrukture, organizative, si dhe kriteret e lidhura me personelin akademik e ndihmës që do të përfshihen në realizimin e disiplinave apo veprimtarive të tjera formuese, duke marrë në konsideratë dhe objektivat e nevojat për zgjerimin e sistemit të arsimit të lartë.

e) IAL-të që paraqesin dokumentacionin sipas kreut II të këtij udhëzimi dhe kriterëve të posaçme të këtij kreu, për hapjen e programeve të studimit. Strukturat shëndetësore universitare që janë pjesë integrale e tyre duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për

strukturat shëndetësore universitare, si dhe standardet specifike të programeve të studimit. Të njëjtat kritere dhe standarde specifike duhet të plotësojnë edhe strukturat shëndetësore universitare me të cilat IAL-ja që paraqet kërkesën për hapjen e programeve të studimit, ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e programit të studimit.

f) IAL-të që paraqesin kërkesën për hapjen e programeve të studimit, duhet të dokumentojnë/verifikojnë paraprakisht që struktura spitalore dhe rrjeti formues që do të angazhohet në secilin program studimi, plotëson kriteret dhe standardet specifike të programeve të studimit.

g) Programet e studimit mund të organizohen dhe zhvillohen bashkërisht nga IAL-të të cilat kanë domosdoshmërisht njësi baze dhe njësi kryesore në fushën e mjekësisë, mbi bazën e marrëveshjeve ndër-institucionale përkatëse, si dhe marrëveshjeve specifike për organizimin e këtyre programeve. Në këtë rast, institucioni përgjegjës për realizimin dhe mbarëvajtjen e tyre është IAL-ja pranë të cilit zhvillohet pjesa më e madhe e veprimtarisë dhe mbahet dokumentacioni i procesit mësimor. IAL-ja përgjegjëse për realizimin dhe mbarëvajtjen e programit të studimit duhet të disponojë burimet financiare, infrastrukturën dhe personelin akademik të nevojshëm për realizimin e programit të studimit.

h) Për realizimin e programeve të studimit, IAL-të mund të lidhin marrëveshje bashkëpunimi me struktura shëndetësore universitare të huaja, të licencuara për zhvillimin e aktivitetit shëndetësor në vendin e origjinës. Në këtë rast, kërkesa e IAL-së për hapjen e programeve të studimit shoqërohet edhe me statusin ligjor dhe dokumentacionin ligjor të strukturës shëndetësore universitare të huaj për zhvillimin e aktivitetit shëndetësor në vendin e origjinës, si dhe konfirmimin e këtij statusi nga ministri i MASR-së dhe ministri përgjegjës për shëndetësinë në Republikën e Shqipërisë.

i) Për realizimin e programeve të përbashkëta të studimit me IAL të huaja zbatohen standardet shtetërore të cilësisë të vendit, ku zhvillohet pjesa më e madhe e veprimtarisë mësimore të programit.

j) Nevoja për formim të specializuar në kuadër të programit të studimit dhe madhësia e rrjetit formues përcaktohet mbi bazën e kapacitetit formues të strukturës shëndetësore, edhe në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë.

k) Rrjeti formues është përcaktuar në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, në bazë të marrëveshjeve dhe protokolleve të nxitura nga IAL-të interesuara.

2. Personeli akademik i programit të studimit të ciklit të tretë “Specializime afatgjata në fushën e mjekësisë”

a) Personeli akademik i programit të studimit përbëhet nga pedagogë të angazhuar me punë klinike/diagnostike dhe me tituj akademikë, si: *profesor, profesor i asociuar* ose gradë shkencore *doktor/PhD*.

b) Personeli akademik i programit të studimit përbëhet nga:

i) Personel akademik me kohë të plotë me tituj akademikë dhe grada shkencore, jo më pak se 50% të pedagogëve që mbulojnë programin e studimit. Të paktën 1 (një) pedagog me kohë të plotë, me titullin akademik “Profesor”, duhet t’i përkasë fushës së programit të studimit.

ii) Personeli akademik me kohë të integruar, në masën jo më shumë se 50% e pedagogëve që mbulojnë programin e studimit, të cilët ushtrojnë profesionin në strukturat shëndetësore universitare të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Ky personel akademik të ketë eksperiencë didaktike-formuese dhe eksperiencë profesionale-klinike. Zhvillimi i aktivitetit mësimdhënës nga personeli i strukturave shëndetësore të rrjetit formues kërkon miratimin paraprak të drejtuesit të strukturës shëndetësore.

iii) Personel akademik me kohë të pjesshme, për disiplina të veçanta, jo më shumë se 10% e pedagogëve që mbulojnë programin e studimit, me të cilët lidhet një kontratë sipas nevojave të strukturës së programit të studimit.

c) IAL-të dhe strukturat shëndetësore të rrjetit formues të tyre, sipas kompetencave respektive, përcaktojnë mënyrën e përfshirjes së personelit të strukturave shëndetësore universitare, në zbatimin e programit të studimit.

d) Përgjegjësi/Drejtuesi i programit të specializimit duhet të jetë personel akademik me kohë të plotë. Përgjegjësi/Drejtuesi i programit të specializimit është njëkohësisht edhe kryetari i Këshillit Drejtues të programeve të studimeve specializuese afatgjata, zgjidhet nga anëtarët e këtij këshilli me shumicë të thjeshtë votash (50% + 1). Përgjegjësi i një programi studimi në një IAL nuk mund të ngarkohet me përgjegjësinë e drejtimit të një tjetër programi studimi që realizohet nga IAL-të.

e) Këshilli drejtues i programit të studimit të specializimeve afatgjata punon për përgatitjen, organizimin dhe kontrollin e programit të specializimit përkatës. Këshilli Drejtues i programit përkatës të studimeve specializuese afatgjata ngrihet në nivel njësie kryesore dhe përbëhet nga të paktën 5 (pesë) pedagogë me kohë të plotë të IAL-së, jo më pak se 2 (dy) pedagogë për çdo program studimi që ofron njësi kryesore, të cilët duhet të jenë figura të spikatura në fushën e specialitetit përkatës, me përvojë klinike dhe akademike të paktën 10-vjeçare.

f) Drejtimi i specializantit i ngarkohet, në cilësinë e udhëheqësit, një pedagogu (udhëheqës akademik) dhe/ose një anëtar i personelit të strukturës shëndetësore të rrjetit formues (udhëheqës klinik/tutori) të programit të studimit i cili/të cilët udhëheqin specializantin gjatë gjithë periudhës së specializimit dhe janë përgjegjës për drejtimin, këshillimin, vlerësimin e nevojave të studentit, si edhe për zhvillimin dhe monitorimin e punës së studentit.

g) Fusha e specializimit të udhëheqësit përputhet me atë të programit specializues që ndjek specializanti. Udhëheqësi klinik/tutori ka një eksperiencë profesionale të paktën 10-vjeçare (dhjetëvjeçare) me përvojë klinike në fushën klinike përkatëse dhe ka të paktën gradën shkencore “Doktor”. Numri maksimal i studentëve specializantë që mund të ndiqet nga udhëheqësi akademik /klinik është 3 (tre).

h) Udhëheqësi klinik/tutori është personel i punësuar me kohë të plotë pranë njëres nga strukturat e rrjetit formues dhe ka kontratë bashkëpunimi me IAL-në që ofron programin specializues. Kur tutori nuk është pjesë e personelit me kohë të plotë të strukturës që ofron programin e specializimit, specializantit i caktohet edhe një udhëheqës akademik, anëtar i personelit akademik me kohë të plotë të institucionit. Për caktimin e udhëheqësit klinik merret mendimi i drejtuesit të strukturës shëndetësore dhe udhëheqja e tij klinike konsiderohet si pjesë e orarit të punës.

i) Aktiviteti i mësimdhënies kryhet njëkohësisht me aktivitetin asistencial/profesional, në përputhje me kërkesat e programit të studimit. Zhvillimi i aktivitetit mësimdhënës në selinë ku realizohet programi i studimit nga personeli i strukturave shëndetësore universitare kërkon miratimin paraprak të drejtuesit të këtij shërbimi.

j) Specializanti i përfshirë në rrjetin formues merr gradualisht përgjegjësi klinike gjatë specializimit.

k) Kriteret, kuotat, tarifat dhe modalitetet e pranimit në programet e studimit propozohen nga njësi/njësitë bazë propozuese të programit të studimit, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë. Ato bëhen publike pas miratimit nga organet drejtuese të IAL-së dhe i përcillen Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe MASR-së.

l) IAL-të duhet të përcaktojnë modalitetet e koordinimit dhe gjenerimit të kuotave për specializimet afatgjata në fushën e mjekësisë, me kërkesat të sistemit shëndetësor kombëtar nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë.

m) Gjatë periudhës së studimeve në një program studimi, studenti nuk mund të ndjekë njëkohësisht programe të tjera studimi, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer.

3. Organizimi i programit të studimit të ciklit të tretë “Specializime afatgjata në fushën e mjekësisë”.

a) Programet e studimit të ciklit të tretë, “Specializime afatgjata në fushën e mjekësisë”, përfshijnë të paktën 80% të ECTS-ve totale për aktivitete klinike profesionalizuese dhe 20% të ECTS-ve totale për studime të organizuara teorike, të shpërndara në vite, sipas një plani të studimit.

b) Raporti i lëndëve të përcaktuara në programin e studimit përbëhet nga:

i) 60% lëndë specifike;

ii) 30% lëndë karakterizuese të fushës;

iii) 5% lëndë të formimit bazë, ndërdisiplinore ose integruese dhe për aktivitete të tjera;

iii) 5% provimi përfundimtar etj.

15% e totalit të lëndëve specifike dhe 15% e totalit të lëndëve karakterizuese duhet të jenë lëndë me zgjedhje.

c) Njësi bazë propozuese harton Rregulloren e programeve të studimeve specializuese afatgjata, me anekset specifike për çdo program, në të cilën parashikohen të gjitha proceset dhe elementet përbërëse të nevojshme për realizimin e programit, dhe ia paraqet Senatit Akademik të IAL-së për miratim. Në rregullore duhet të përcaktohet edhe:

i) vlerësimi i njohurive teorike dhe praktike të specializantit, në fund të çdo viti akademik;

ii) modalitetet e vlerësimit përfundimtar të specializantit, i cili i nënshtrohet provimit përfundimtar përkatësisht për njohuritë teorike, praktike ose paraqitjes së temës eksperimentale-studimore të diplomës.

d) Nevoja për formim të specializuar në kuadër të programit të studimit dhe madhësia e rrjetit

formues përcaktohet mbi bazën e kapacitetit formues të strukturës shëndetësore universitare edhe në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë.

e) Për realizimin e programit të studimit, IAL-të garantojnë personelin akademik të nevojshëm me tituj dhe grada shkencore.

f) Në kuadër të programit të studimit, specialistët caktohen pranë njësive /shërbimeve/repartëve të strukturave shëndetësore universitare, pjesë e rrjetit formues, në përputhje me planin e studimit të miratuar dhe për kohën e nevojshme për të fituar aftësitë profesionale.

KREU VI

KRITERET E POSAÇME PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË CIKLIT TË TRETË TË STUDIMIT “DOKTORATË”

1. Kriteria të përgjithshme për hapjen e programeve të reja të ciklit të tretë të studimit “Doktoratë”

a) Programet e studimit “Doktoratë” mund të hapen dhe të ofrohen nga IAL-të publike dhe jopublike që kanë statusin Universitet ose Akademi, vendëse ose të huaja, të cilat kanë programe studimi të licencuara dhe akredituara/riakredituara të ciklit të parë dhe të dytë në të njëjtën fushë ose fushë të përafërt me atë të programit “Doktoratë”.

b) IAL-të që paraqesin dokumentacionin sipas kreut II të këtij udhëzimi dhe kriterëve të posaçme të këtij kreu, për hapjen e programeve të reja të ciklit të tretë të studimit “Doktoratë”.

c) Programet e studimit të doktoratës realizojnë formimin bazuar mbi hartimin e projekteve individuale për aftësimin e pavarur të kërkimit shkencor, duke u dhënë doktorantëve një kulturë ndërdisiplinare në kuadër të një projekti shkencor inovativ, që ka për qëllim përgatitjen e tyre shkencore dhe profesionale. IAL-ja depoziton së bashku me dokumentacionin për hapjen e programeve të studimit edhe projektet kërkimore—shkencore të hartuara për programin e studimit.

d) IAL-të nxisin nivelin e zhvillimit të kërkimit shkencor dhe ndihmojnë në aftësimin e studentit për të përfunduar me sukses programin e studimit.

e) IAL-të, në kuadër të programit të studimit organizojnë aktivitete me impakt në formimin e përgjithshëm, si dhe këshillojnë studentët të marrin pjesë në aktivitete dhe konferenca shkencore, seminare dhe debate ndërdisiplinore, të lidhura ngushtë me fushën specifike në të cilën ndjekin studimet dhe që i ndihmojnë në punën e tyre kërkimore, sipas përcaktimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme të IAL-ve.

f) IAL-të ndihmojnë në aftësimin e studentit për përvetësimin e metodologjive të kërkimit për veprimtari krijuese të pavarura, si: artikuj shkencorë, prezantime, qasje standarde për referenca, bibliografi, indekse dhe të shkruarit e përmbajtjes, si bazë për përpunimin e tezës së doktoratës, punën e pavarur, përdorimin e burime të informacionit, administrimin dhe përpunimin e informacionit, përdorimin e teknologjive bashkëkohore për studime e komunikime, përvetësimin e metodave të avancuara të analizës dhe përpunimit të të dhënave, njohjen dhe përvetësimin e terminologjisë së specializuar lidhur me fushën kërkimore të doktorantit, si edhe përvetësimin e aftësive komunikuese me nivel shkencor.

g) Për realizimin e projektit kërkimor, IAL-të garantojnë personelin e tyre akademik të nevojshëm me tituj dhe grada shkencore.

h) IAL-ja ofruese e programit të studimit duhet të ketë struktura administrative dhe kërkimore të mjaftueshme për aktivitetet e parashikuara për kryerjen e kërkimeve dhe mund të bashkëpunojë me një apo më shumë IAL, vendëse apo të huaja, në bazë të marrëveshjeve të lidhura midis tyre, në mbështetje të procesit dhe përmirësimit të standardeve.

i) Programet e studimit kanë një kohëzgjatje jo më pak se 3 vite akademike dhe jo më shumë se 5 vite akademike dhe zhvillohen me kohë të plotë. Shtyrja e kohëzgjatjes bëhet sipas procedurave të përcaktuara në statutet e institucionit. Në rastet kur doktoranti është i punësuar si personel akademik, kërkimor, shkencor në një institucion tjetër të arsimit të lartë, të kërkimit bazë ose të zbatuar, programi i studimit mund të zhvillohet me kohë të zgjatur. Në këtë rast, IAL-të përcaktojnë vetë tarifën shtesë të studimit.

2. Personeli akademik i programit të studimit të ciklit të tretë “Doktoratë”

a) Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit përbëhet nga pedagogë me tituj akademikë të kategorisë “Profesor”.

b) Në rastet kur programet e studimit do të kryhen bashkërisht me një IAL të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, Kanadasë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, udhëheqësi i IAL-së së

huaj mund të jetë edhe me gradën shkencore “Doktor”/PhD.

c) Drejtuesi shkencor i studentit është përgjegjës për drejtimin, këshillimin, vlerësimin e ecurisë të studentit, si dhe përparimin e punës kërkimore të zhvilluar.

d) Njësia bazë ngarkon një prej anëtarëve të personelit akademik të programit të studimit që mban të paktën titullin akademik të kategorisë “Profesor”, në cilësinë e përgjegjësit të programit të studimit.

3. Organizimi i programit të studimit të ciklit të tretë “Doktoratë”

a) Përgjegjësi i programit të studimit ndjek të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me planifikimin dhe zbatimin e programit të kërkimeve, duke siguruar praninë dhe angazhimin e personelit akademik të kualifikuar në fushën shkencore të këtij programi.

b) Njësia bazë propozuese harton rregulloren e programit të studimit në të cilën parashikohen të gjitha proceset dhe elementët përbërës të nevojshëm për realizimin e këtij programi. Rregullorja miratohet nga Senati Akademik.

c) Në përfundim të çdo viti akademik, drejtuesi shkencor miraton raportin e aktiviteteve të kryera nga doktorantët në përputhje me rregulloren e ciklit të programit të studimit.

d) Programet e studimit mund të hapen dhe zhvillohen bashkërisht midis IAL-ve mbi bazën e marrëveshjeve ndërinstitucionale përkatëse. Në këtë rast, selia administrative dhe institucioni përgjegjës për realizimin dhe mbarëvajtjen e tyre është IAL-ja pranë të cilit zhvillohet pjesa më e madhe e veprimtarisë dhe mbahet dokumentacioni i procesit mësimor.

e) IAL-ja përgjegjëse për realizimin dhe mbarëvajtjen e programit të studimit duhet të disponojë burimet financiare, infrastrukturën dhe personelin akademik të nevojshëm për realizimin e programit të studimit.

f) Për realizimin e programeve të përbashkëta të studimit me institucione të huaja të arsimit të lartë mund të zbatohen standarde të ndryshme nga ato shtetërore, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.

g) Kriteret, kuotat, tarifat dhe modalitetet e pranimin në programet e studimit propozohen nga njësia/njësitë bazë propozuese e/të programit të studimit, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë dhe miratohen nga organet drejtuese të IAL-së. Ato bëhen publike nga IAL-të dhe i përcillen Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe MASR-së.

h) Gjatë periudhës së studimeve në një program studimi, studenti nuk mund të ndjekë njëkohësisht programe të tjera studimi, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer.

KREU V

KRITERET E POSAÇME PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË CIKLIT TË TRETË TË STUDIMIT, “MASTER EKZEKUTIV”

1. Kriteret të përgjithshme për hapjen e programeve të reja të ciklit të tretë të studimit, “master ekzekutiv”.

a) IAL-të që paraqesin dokumentacionin sipas kreut II të këtij udhëzimi dhe kriterëve të posaçme të këtij kreu, për hapjen e programeve të reja të ciklit të tretë të studimit, “master ekzekutiv”.

b) Programet e studimit “master ekzekutiv” mund të hapen dhe të ofrohen nga IAL-të publike dhe jopublike që kanë statusin Universitet ose Akademi, vendëse ose të huaja, të cilat kanë programe studimi të licencuara dhe akredituara/riakredituara të ciklit të parë dhe të dytë në të njëjtën fushë ose fushë të përafërt me atë të programit “master ekzekutiv”. Gjithashtu, kërkesa mund të paraqitet edhe nga IAL-të të cilat nuk kanë programe studimi të licencuara dhe akredituara/riakredituara të ciklit të parë dhe të dytë në të njëjtën fushë ose fushë të përafërt me atë të programit “master ekzekutiv”, por që plotësojnë njëkohësisht kushtet e mëposhtme:

- kanë akreditim institucional;

- kanë përvojë në ofrimin e programeve të studimit të ciklit të tretë;

- dëshmojnë se kanë personelin akademik për të plotësuar, menjëherë pas licencimit të programit, strukturën e departamentit që ofron programin e studimit.

c) Programet e studimit mund të hapen dhe zhvillohen bashkërisht midis IAL-ve mbi bazën e marrëveshjeve ndërinstitucionale përkatëse. Në këtë rast, institucioni përgjegjës për realizimin dhe mbarëvajtjen e tyre është IAL-ja pranë të cilit zhvillohet pjesa më e madhe e veprimtarisë dhe mbahet dokumentacioni i procesit mësimor.

d) IAL-ja përgjegjëse për realizimin dhe mbarëvajtjen e programit të studimit duhet të

disponojë burimet financiare, infrastrukturën dhe personelin akademik të nevojshëm për realizimin e programit të studimit.

e) Për realizimin e programeve të përbashkëta të studimit me institucione të huaja të arsimit të lartë, mund të zbatohen standarde të ndryshme nga ato shtetërore.

2. Personeli akademik i programit të studimit të ciklit të tretë, “master ekzekutiv”

a) Personeli akademik i programit të studimit përbëhet nga personeli akademik i kategorisë “Profesor” i punësuar me kohë të plotë ose të pjesshme në IAL. Në personelin akademik të programit të studimit mund të përfshihet edhe personeli akademik i IAL-ve partnere në hapjen e programeve të studimit mbi bazën e marrëveshjeve ndërinstitutionale.

b) Në varësi të shkallës së specializimit të programit të studimit, mund të jenë pjesë e personelit të programit edhe specialistë të fushës me përvojë profesionale në fushën e programit, numri i të cilëve nuk mund të jetë më i lartë se 30% e personelit akademik.

3. Organizimi i programit të studimit të ciklit të tretë, “master ekzekutiv”

a) Programet e studimit hapen në përputhje me Standardet Shtetërore të Cilësisë për programet e studimit të ciklit të tretë, me kohëzgjatje 1 ose 2 vite akademike (respektivisht me 60 ose 120 kredite ECTS).

b) Struktura e programit të studimit pasqyrohet e plotë në planin mësimor ndërsa modalitetet e realizimit të programit të studimit dhe të veprimtarive të tij pasqyrohen në rregulloren e programit të studimit.

c) Veprimtaritë mësimore mund të zhvillohen në formën e leksioneve, seminareve, laboratorëve, praktikave mësimore, vizitave mësimore, konferencave, mësimi ndërkativ, stazheve.

d) Praktikat mësimore dhe stazhet mund të zhvillohen pranë institucionit të arsimit të lartë ose pranë institucioneve të tjera bashkëpunuese, në varësi të objektivave formuese dhe të strukturave që disponon vetë IAL-ja.

e) Veprimtaritë mësimore, për programet e studimit me kohëzgjatje 1 vit akademik, nuk duhet të përmbajnë më pak se 360 orë në auditor.

f) Veprimtaritë mësimore, për programet e studimit me kohëzgjatje 2 vite akademike, nuk duhet të përmbajnë më pak se 720 orë në auditor.

g) Programet e studimit përmbillen me tezë diplome.

h) Njërit prej anëtarëve të personelit akademik të programit të studimit që mban të paktën titullin “profesor i asociuar” i ngarkohet, në cilësinë e përgjegjës, drejtimi i programit të studimit. Përgjegjësi i një programi studimi në një IAL nuk mund të ngarkohet me përgjegjësinë e drejtimit të një programi tjetër studimi që realizohet nga IAL-ja. Për planifikimin dhe zbatimin e planit të studimit, përgjegjësi i programit të studimit bashkëpunon me personelin akademik të këtij programi.

i) Kriteret, kuotat, tarifat dhe modalitetet e pranimi dhe transferimit në programet e studimit përcaktohen nga njësia/të bazë propozuese të programit të studimit, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë dhe miratohen nga organet drejtuese të IAL-së. Ato bëhen publike nga IAL-të dhe i përcillen Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe MASR-së.

j) Gjatë periudhës së studimeve në një program studimi, studenti nuk mund të ndjekë njëkohësisht programe të tjera studimi, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer.

KREU VIII

KONTROLLET DHE MASAT

1. Programet e studimit të ofruar nga IAL-të i nënshtrohen kontrolleve të zbatimit të ligjshmërisë nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të paktën një herë në 3 vjet. Nëse gjatë kontrolleve evidentohen shkelje të dispozitave të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” apo të akteve nënligjore, grupi i kontrollit i ngritur me urdhër të ministrit të MASR-së përgatit një raport për ministrin mbi shkeljet e evidentuara. Raporti i grupit të kontrollit i dërgohet edhe IAL-së përkatëse.

2. Pas njoftimit mbi shkeljet dhe detyrimet mbi zbatimin e normave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, institucioni dërgon komentet dhe sqarimet e tij (nëse ka) në lidhje me raportin e hartuar nga grupi i kontrollit. Grupi i kontrollit pasqyron në raportin përfundimtar saktësimet që i gjykon të arsyeshme dhe jep qëndrimin përkatës për pjesën e refuzuar të vërejtjeve të institucionit të arsimit të lartë.

3. Pas marrjes së raportit përfundimtar, institucioni dërgon një deklaratë të firmosur (deklaratë angazhimi), në të cilën angazhohet se do të plotësojë brenda afatit të përcaktuar nga MASR-ja kriteret e paplotësuara sipas kërkesave të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në fuqi.

4. Në rast se institucioni nuk arrin të zbatojë angazhimet brenda afatit të përcaktuar, ministri i MASR-së pezullon programin përkatës të studimit deri në përmbushje të detyrimeve ose mbyllje të programit të studimit.

5. Mbyllja e programeve të studimit bëhet me urdhër të ministrit të MASR-së, në fund të vitit akademik. Studentët që nuk kanë përfunduar ende studimet në programin që mbyllet, kanë të drejtë të transferojnë studimet brenda të njëjtë institucion ose në një institucion tjetër të arsimit të lartë.

KREU IX DISPOZITA TRANZITORE TË FUNDIT

1. Në zbatim të nenit 129, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, përjashtëmish aplikimet për hapje /riorganizim të programeve të reja/ekzistuese të studimit do të pranohen gjatë vitit akademik 2017-2018 për vitin 2018-2019 dhe në vijim deri në muajin korrik të vitit 2018.

2. Aplikimet në vitet në vijim për hapje/riorganizim të programeve të reja /ekzistuese të studimit bëhen brenda datës 30 nëntor të vitit korrent për vitin e ardhshëm akademik.

3. Udhëzimi nr. 11, datë 28.2.2011, “Për procedurat dhe dokumentacionin për hapjen e një institucioni privat të arsimit të lartë, programeve të studimit universitar në ciklin e parë dhe ciklin e dytë, programeve të studimeve jouniversitare, të natyrës profesionale, si dhe procedurat për pezullimin dhe revokimin e licencës”, shfuqizohet në pjesët që rregullon programet e studimit.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Lindita Nikolla

Shtojca 1

KËRKESË PËR HAPJEN DHE/OSE ORGANIZIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Institucioni i arsimit të lartë: _____

Viti akademik: _____

Data e kërkesës: _____._____._____

I. INFORMACION MBI INSTITUCIONIN

Të dhënat për aktet themelore	Lloji i aktit (VKM/urdhër)	Nr.	Datë
Licencimi i institucionit			
Leja për fillimin e veprimtarisë			
Akreditimi i institucionit			
Hapja/riorganizimi i njësisë kryesore ku ofrohet programi			
<i>Në rastin e aplikimeve për hapjen e programeve të ciklit të tretë</i>			
Hapja e programeve të ciklit të parë në të njëjtën fushë/fushë të përafërt			
Akreditimi i programeve të ciklit të parë në të njëjtën fushë/fushë të përafërt			
Hapja e programeve të ciklit të dytë në të njëjtën fushë/fushë të përafërt			
Akreditimi i programeve të ciklit të dytë në të njëjtën fushë/fushë të përafërt			

II. INFORMACION MBI PROGRAMIN E STUDIMIT

1. Të dhëna të përgjithshme:

Emërtimi i programit të studimit:	
-----------------------------------	--

Cikli i studimeve:	
Lloji i programit:	
Kodi i programit:	
Totali i krediteve (ECTS):	
Kohëzgjatja normale në vite	
Forma e studimit:	
Gjuha e studimit:	
Vendimi i njësisë bazë dhe kryesore për hapjen e programit të studimit (Numri i vendimit dhe data)	
Vendimi i Senatit Akademik për hapjen e programit të studimit (Numri i vendimit dhe data)	

Shënim. Në rastin kur programi i studimit është i përbashkët, të përfshihen të gjitha vendimet e marra, sipas modelit më sipër.

2. Objektivat formues dhe karakteristikat e programit të studimit

a) Profili kulturor dhe profesional i studentit në përfundim të programit mësimor.

--

b) Njohuritë dhe kompetencat e studentëve në përfundim të programit mësimor

--

c) Mundësitë për punësim

--

3. Struktura akademike përgjegjëse dhe strukturat e tjera bashkëpunuese

Fakulteti apo një strukturë tjetër mësimore e kërkimore	
Struktura të tjera bashkëpunuese brenda institucionit apo në institucione të tjera të arsimit të lartë	
Institucione të huaja të arsimit të lartë	
Subjekte të tjera publike apo private	

Shënim. Në rastin e bashkëpunimit me një apo disa struktura të tjera, të bashkëlidhen marrëveshjet përkatëse.

4. Kuadri i përgjithshëm formues i programit të studimit

Kuadri i përgjithshëm formues i programit të studimit hartohet bazuar në standardet shtetërore dhe kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi.

5. Personeli akademik për realizimin e programit

Personeli akademik (emri, mbiemri)	Titulli/grada shkencore	Institucioni	Njësia kryesore	Njësia bazë	Lloji i angazhimit (me kohë të plotë/të pjesëshme)

6. Plani mësimor me përbërësit specifike sipas kuadrit ligjor në fuqi.

7. Infrastruktura në dispozicion të programit (Informacion lidhur me: auditorët, laboratorët e duhur, bibliotekën, mjetet kompjuterike sistemet IT etj.

8. Kriteret e pranimit të studentëve në program.

Numri i propozuar i studentëve që do të pranohen në program	
Numri minimal i studentëve për hapjen e programit	

9. Tarifa e shkollimit

Tarifa e shkollimit		Kostoja e shkollimit	
---------------------	--	----------------------	--

10. Financimi i programit

Burimi i financimit të programit. Financime të tjera që mund të mbulojnë pjesërisht apo plotësisht koston e shkollimit, nëse ka të tilla.

III. DEKLARATA PËR PLOTËSIMIN E STANDARDEVE AKADEMIKE DHE STANDARDEVE SHTETËRORE SIPAS AKTEVE LIGJORE E NËNLIGJORE NË FUQI

--

IV. AUTODEKLARIM

Ne/Unë i/e nënshkruari/a _____

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

1. Të gjithë të dhënat janë të vërteta dhe jam i vetëdijshëm për përgjegjësinë penale në rast dhënie informacioni të pavërtetë, si dhe pranoj t'i nënshtrohem verifikimit nga organet përkatëse për të gjithë informacionin e paraqitur si më sipër.

2. IAL-ja është e regjistruar në QKB si person juridik, me të drejtën e ushtrimit të aktivitetit në fushën përkatëse të arsimit, si më poshtë:

Subjekti juridik përgjegjës për IAL-në _____:

NUIS: _____:

3. Subjekti juridik disponon vërtetim pronësie nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, nr.____, datë ____/____/____ ku do të zhvillohet veprimtaria, apo kontratë qiraje me kohëzgjatje jo më pak se tri vite akademike nga momenti i paraqitjes së kësaj kërkesë.

4. Deklaroj se subjekti juridik disponon mjedis të përshtatshëm për realizimin e procesit mësimor, bazën materiale të nevojshme sipas standardeve shtetërore në fuqi.

5. Deklaroj se subjekti juridik ka krijuar kushteve për studentët me aftësi të kufizuara në mjediset ku ushtrohet veprimtaria e mësimdhënies.

6. Subjekti juridik dhe personat përgjegjës për administrimin e tij nuk janë në proces gjykimi, hetimi, si dhe nuk rezultojnë të dënuar në fushën që kërkohet të ushtrohet aktiviteti.

7. Deklaroj se subjekti juridik plotëson të gjitha standardet akademike dhe shtetërore sipas kuadrit ligjor në fuqi.

8. Deklaroj se subjekti juridik plotëson të gjitha standardet infrastrukturore shtetërore sipas kuadrit ligjor në fuqi.

9. Deklaroj se subjekti juridik nuk rezulton debitor ndaj organeve tatimore në nivel qendror dhe vendor për të gjitha llojet e detyrimeve, përfshirë energjinë elektrike dhe furnizimin me ujë.

10. Deklaroj se subjekti juridik disponon lejen higjieno-sanitare për çdo mjedis ku do të zhvillohet veprimtaria dhe aktin për mbrojtjen kundër zjarrit, brenda afateve të vlefshmërisë.

11. Deklaroj se subjekti juridik disponon vlerat monetare për financimin e programit përkatës të studimit dhe është përgjegjës ndaj studentëve për mos respektimin e kontratave të lidhura.

Data _____

REKTORI

Firma,
vula

ADMINISTRATORI I PERSONIT JURIDIK PËRGJEGJËS PËR IAL-NË JOPUBLIKE

Data _____

Firma,
vula